



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog
Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and
Finance Committee

33	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	26.02.2021 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Drejtorët: Hysni Maxharraj, Edona Bujupi-Loxha Hazbi Bajraj, Mujë Osmanaj, Drin Sadikaj, Lulzim Blakaj, Demë Qeta, Zyrtar Administrativ: Flora Bujupaj, Fjollë Berisha.
Rendi i ditës: <ol style="list-style-type: none">1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Komitetit,2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 22.01.2021,3. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e katërt (tetor-dhjetor) të vitit fiskal 2020,4. Raporti i punës së KKS-së për vitin 2020,5. Shpallja në diskutim publik i Draft-Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve,6. Shpallja në diskutim publik i Draft-Rregullores për Mirëmbajtjen Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave,7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësim-ndryshimin e vendimit 01 Nr. 79/2020 i datës 04.12.2020.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj - përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjera janë pajisur me maska, dorëza dhe dezinfektues në tavolina.</p> <p>Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.</p> <p>Prezanton rendin e ditës,</p>	

Kryesuesi hedh në votim rendin e ditës. Miratohet rendi i ditës unanimit.	
Vendimet:	
Miratohet rendi i ditës në mënyrë unanime.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj- Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, Konstatohet që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa janë prezentë në këtë mbledhje, përveç Zenel Shatri i cili shpejt do të na bashkëngjitet (ka marrë pjesë në mbledhje) dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.	
Vendimet:	
Vazhdojmë me mbledhjen	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. a ka dikush diçka? Pasi që diskutime nuk pati hedh në miratim. Miratohet një zëri procesverbali nga mbledhja e kaluara. Të gjithë anëtarët e Komitetit prezent.	
Vendimet:	
Miratohen njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Shqyrtimi i pikës 3.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ja kaloj fjalën drejtorit të drejtoratit për Buxhet dhe Financa z. Hysni Maxharraj. Hysni Maxharraj- prezanton raportin financiar për 3 mujorin e katërt (tetor-dhjetor)të vitit fiskal 2020. Eliot Kukiqi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha ta pyes drejtorin te këto projektet kapitale 322,000.00 që kanë mbetur në raport vjetor a mundet me ndryshuar kjo shumë? Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Këtu rreth këtyre realizimeve e kam një pyetje, me ato mbetjet e realizimit të projekteve a është planifikuar që ato të futen diku a si do të ja bëni kjo	

shumë projekte kanë tepruar, d.m.th mbetje prej realizimit të projekteve, edhe këtu që po barten disa projekte, më përpara që ka qenë projekti me numër 49044 ku është ndërtimi i trotuarit Vrellë-Kamenicë-Stupe, Kamenica le të fshihet, kush është për këtë, te projekti 50261 riparimi i bustacioneve, kisha pas qejf me ja u propozuar pasi që është kompetencë e komunës që mos me pas probleme për këto bustacionet, t'i bëhet një bazë betoni, të rregullohet njëherë mirë, edhe në shumicën e projekteve kjo është e përgjithësuar kjo shumë herë është bartur, por e kom te projekti 50321 pajisja e kabinetit të fizikës-kimisë-biologjisë-historisë, pra me 25 mijë euro me specifikuar për ku bëhet fjalë, d.m.th për cilën shkollë. Nëse ka mundësi se nuk po e dimë. E kam edhe një pyetje te projekti 50307 inventarizimi i shtëpisë së kulturës në Banjë, nuk kam informacion a ekziston, a shfrytëzohet, a duhet të inveratrizohet a jo. Faleminderit kaq pata!

Hysni Maxharraj- sqaron se të gjitha mjetet e mbetura nga projektet barten në projekte tjera që janë në listë të borxheve.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -pasi që ky është raport, do ta kemi prapë në kuadër të raportit të vitit 2020 dhe do të debatojmë më shumë dhe më qartë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: raportin financiar për 3 mujorin e katërt (tetor-dhjetor)të vitit fiskal 2020 ja kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës: Raporti i punës së KKSB-së për vitin 2020, e dini që Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi është i formuar ka mbajt takime, kemi pasur raporte edhe me herët me planin e punës së tyre, por ky vit ka qenë pak më ndryshe, raportin e keni pasur në material, prandaj unë rreth kësaj i jap fjalën nënkryetarit të komunës z. Agim Ademaj.

Nënkryetari Agim Ademaj- prezanton raportin e punës së KKSB-së për vitin 2020.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: Raportin e punës së KKSB-së për vitin 2020 ja kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik i Draft-Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, lidhur me këtë fjalën ja kalojë Drejtoreshës së Administratës znj. Edona Bujupi-Loxha.

Edona Bujupi-Loxha -përshëndet të gjithë të pranishmit! sa i përket Rregullores për Përkujdesjen

dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, ne si komunë e kemi pasur edhe më herët d.m.th para dy viteve, mirëpo për shkak të ndryshimit të ligjeve që kanë hyrë në fuqi ligje të reja ne jemi të detyruar jo vetëm ne, po të gjitha komunat, t'a ndryshojnë edhe Rregulloren, kjo është vetëm shpallje në diskutim publik pastaj prapë do të kthehet në KPF dhe në mbledhjen e Kuvendit do të diskutohen të gjitha dhe nuk besoj që mundemi me e pasur ndonjë problem. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj - pra drafti është i përgatitur nga komisioni komunal të cilin e ka udhëhequr drejtoresha, nëse ka dikush prej jush ka diçka rreth kësaj Rregulloreje, pasi që nuk ka pyetje apo diskutime tjera.

Hedh në miratim këtë Draft-Rregullore.

Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, i rekomandojnë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim të Shpalljes në diskutim publik të Draft-Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve,

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF unanim rekomandon: Shpallja në diskutim publik i Draft-Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe të njëjtin ia kalon KK për shqyrtim dhe miratim

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik i Draft-Rregullores për Mirëmbajtjen Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave. Edhe këtu e kemi pasur një Rregullore, tash i ka pësuar disa ndryshime më shumë prandaj lidhur me këtë ja kaloj fjalën drejtorit të drejtoratit të Shërbimeve Publike, z. Enver Rugova.

Enver Rugova- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket Rregullores komunale të vitit 2015 me kërkesë të komuniteteve fetare, pikërisht të bashkësisë islame në komunën e Istogut që i është bërë kryetarit të komunës kemi filluar me ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mirëpo jemi deshmitar të ndryshimit dhe plotësimi të shumë ligjeve në parlamentin e Kosovës kështu që jemi munduar që t'i inkorporojmë të gjitha ato ndryshime dhe plotësime që i përkasin asaj lëmie. Përpos nenit 8 të gjitha nenet tjera kanë pësuar një ndryshim se paku lektoror dhe jemi munduar komisioni që ka punuar në këtë drejtim shumë profesional jemi, që të gjitha ato paqartësi në leximin e neneve dhe pikave të jenë të lexueshme, kuptueshme dhe aplikueshme, nëse dëshironi mund t'i lexoj me radhë por kjo mund të pësoj ndryshime, te neni 4 e kemi çështjen më kryesore edhe më interesante që është pagesa për familjet që ju vdes anëtari i familjes. D.m.th po i lexoj tri pika që i përfshinë neni 4, pika 14 : Të gjithë qytetarët e Komunës se Istogut të cilët dëshmojnë me dokumente se janë qytetarë rezident ju kompensohen shpenzimet e varrimit në shumë prej 200 €, ne e kemi përcaktuar këtë shumë, mirëpo i mbetet Kuvendit që ta përcaktojë. Kemi pikën 15 po prapë të këtij neni: Obligohet familja të sjell certifikatën e vdekjes dhe certifikatën e vendbanimit të të vdekurit në Drejtorinë për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim për pagesë tek zyrtari i caktuar nga Drejtoria, pika 16 : Familja bënë kërkesën për pagesën e shpenzimeve të varrimit brenda afatit prej

30 ditëve në se kalohet ky afat humbet mundësia e kompenzimit. Janë edhe nenet tjera por janë thjeshtë teknike. Këto tri nene unë si drejtor, si sponsorues i këtij plotësim-ndryshimi të kësaj Rregulloreje, ju kisha inkurajuar që ta shqyrtoni këtë edhe në grupet e juaja por edhe së bashku në përgjithësi të caktoni një kuotë çmimi që është e arsyeshme edhe për buxhetin komunal sepse sivjet nuk ka mjete të destinuara ose të planifikuara për këtë aktivitet edhe do ta kemi mjaft vështirë që në këtë situatë që është edhe buxheti i Kosovës apo ai komunal që ka mjete më pak se vitin e kaluar të gjindemi me shuma të tilla sepse gjatë vitit sipas statistikave kemi afër 300 vdekje në komunën e Istogut e nëse është kouta 200 euro atëherë i bie 60 mijë euro. E kjo shumë është koxha problematike me e siguruar në aspekt të subvencionimit. Ju kisha inkurajuar që për muajin e ardhshëm të jeni të pregatitur për këtë situatë mundet me pasur edhe në diskutim propozime tjera edhe ne jemi të hapur dhe mundemi me i inkorporuar në Rregullore. Faleminderit !

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -të nderuar anëtarë të Komitetit e dëgjuat drejtorin dhe njëherësh edhe kryetarin e komisionit të plotësim ndryshimit të kësaj Rregulloreje.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë kam pasur bisedime me disa qytetarë ne e dimë varrimi sa kushton, edhe na e tha edhe drejtori që ne këtë vit nuk kemi planifikuar buxhet e kemi me pasur pak telashe, mirëpo mundësisht propozimi im dhe i qytetarëve është të jetë me i lartë, kjo do të shpallet edhe në diskutim publik e do të japin vërejtje edhe qytetarët, do të vijë prapë në Kuvend ne e miratojmë dhe e shikojmë personalisht jam që kjo shumë të rritet prej 250 deri në 300 euro, pra është propozim i imi dhe i disa qytetarëve që kam biseduar me ta.

Nënkryetari Agim Ademaj- po ju tregoj qartë se si kemi ardhur te kjo shumë, kryetari ka pasur takime të vazhdueshme me përfaqësues të bashkësisë islame, edhe shumë herë është diskutuar me ta, thjeshtë është një propozim i tyre duke e llogarit se ata i dinë sepcifikat sa mundet të jetë shpenzimi për një varrim, ne e kemi pasur Rregulloren paraprake e kemi subvencionu vetëm në raste sociale, ka pasur kërkesa në këtë asamble që të vendoset për të gjithë dhe kjo shumë është sjellë në bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësisë fetare, me pas mundësi ja u bëjmë edhe 1 mijë euro por duhet ta keni parasysh Enveri e tha shumë mirë duhet paur parasysh buxhetin plus që këtë vit nuk kemi të paraparë vijë buxhetore dhe pres që do të kemi telashe në realizimin e zbatimin e kësaj Rregulloreje nëse aprovohet, por si do që të jetë e kemi obligim dhe duhet me u gjind dhe me e zbatuar.

Ajshe Metaj- faleminderit, unë pothuajse e mora përgjigjen. Mua më interesoi me e ditur a ka ekzistuar kjo Rregullore më herët edhe plotësisht pajtohem.

Eliot Kukiqi- unë vetëm desha ta përshëndes drejtorin për këtë iniciativë që e ka marrë për këtë Rregullore, është e qëlluar dhe e domosdoshme, e sa i përket çështjeve të tjera ta shohim në diskutime publike, e kur ka buxhet vitin tjetër p.sh mundemi me e rrit, po për këtë vit ta shohim. Faleminderit!

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Rregulloren për Mirëmbajtjen Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që: Rregullorja për Mirëmbajtjen Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës ,Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësim-ndryshimin e vendimit 01 Nr. 79/2020 i datës 04.12.2020.

Të nderuar anëtarë të Komitetit këtu e kemi pasur një vendim që e kemi marrë në Kuvend e kemi dërguar në shqyrtim të ligjshmërisë na është kthyer, e keni edhe një material që ja u kemi dhënë tash, e keni pasur në adresë por nuk e keni pasur shkresën si duhet pra ka qenë me një gabim titulli jo marrja e vendimit po plotësim-ndryshimi i vendimit. Unë ja kaloj fjalën drejtorit për Ekonomi dhe Zhvillim të na sqarojë më shumë.

Lulzim Blakaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Mbledhjen e kaluar më herët është marrë një vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm megjithëse ka qenë mangësi që para anëtarëve të Kuvendit nuk është prezantuar edhe propozim vendimi, por nga Kuvendi është marrë vendimi edhe i është besuar formulimi i atij vendimi. Kur e kemi dërguar vendimin për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL kanë dalë disa rekomandime nga ata që me vonë e kemi diskutuar edhe me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Në vendimin e mëparshëm e kemi shpallur në interes të përgjithshëm pronën e cila është pronë komunale, sipas dispozitave të Rregullores edhe të Ligjit të ri në fuqi për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale, nocioni "interes i përgjithshëm" është ndërruar me "shpallje në interes të veçantë" d.m.th është një nocion që duhet të korrigjohet dhe ne e kemi korrigjuar me këtë plotësim -ndryshim të vendimit, ka ndryshuar edhe pika e dytë që procedurat e mëtutjeshme zbatohen në pajtim me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale, aty janë ato dispozitat ku përcaktohet bartja e drejtës së pronësisë të cilat administrohen nga niveli qendror d.m.th nga qeveria ose nga agjenci të ndryshme, përcaktohet ecuria se si ato prona tash i barten komunës në pronësi si titullar i pronës. Edhe është përcaktuar në plotësim-ndryshimin që procedurat zbatohen në bazë të atij ligji. Pra ndryshimi është që është shpallë vetëm objekti interes i veçantë, edhe pika e dytë procedurat udhëhiqen dhe zbatohen në pajtim me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale. E tha edhe kryesuesi, ne kemi diskutuar edhe kemi qenë në MAPL, e kemi dërguar këtë formë të vendimit, e kanë parë edhe ata edhe na kanë sugjeruar që përsëri ti paraqitet Komitetit për Politikë dhe Financa edhe Kuvendit me këtë titull "plotësim-ndryshimi i vendimit" në mënyrë që të jemi në rregull me të gjitha procedurat. Nuk kam diçka tjetër të shtoj.

Kryesuesi i Kuvendit- kërkoj falje drejtor, desha të shtoj edhe diçka tjetër këtu, ne vendimin e kemi marrë, kemi biseduar çka duhet me ndryshuar në mënyrë që të jetë i ligjshëm, ne e kemi dërguar vendimin në shqyrtim të ligjshmërisë, MAPL-ja nuk na ka kthyer që është diçka problem vendimi, por na ka kthyer për shkak se është një vendim i qeverisë diku ka muaji maj-qershor është marrë që pezullohet bartja e pronave nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në institucione komunale d.m.th pezullohen kërkesat, por ne kemi biseduar aty që ne me i rregulluar punët tona, edhe kemi marrë fjalë të mira se do të bëhet përjashtim, edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit është e interesuar që

ta dërgojmë këtë dokumentacion të rregulluar dhe të vazhdohet procedura në vlerësim të pronës në mënyrë që vendimet të shkojnë në qeveri ma shpejt. D.m.th edhe pse është ai pezullim ne po insistojmë me kryer punë dhe i kemi disa premtime që do të bëhet, prandaj këtu është edhe esenca. Kaq kisha nëse keni diçka të shtoni urdhëroni? Pasi që diskutime tjera nuk ka. Konstatojmë se në mënyrë unanime Komiteti për Politikë dhe Financa, i rekomandon Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që : Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësim-ndryshimin e vendimit 01 Nr. 79/2020 i datës 04.12.2020. t'i kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Diskutime tjera:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj :

11:00

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Qaush Balaj

